Regjistrimi do të bëhet në **SHFMU "Mati Logoreci" në Prizren**, i cili ofron programin e arsimit dhe aftësimit për të rritur nga klasa e parë deri në klasën e nëntë.

IV. Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

1. Kërkesën për regjistrim;
2. Kopjen e dokumentit të identifikimit ose certifikatën e lindjes;
3. Dëshmitë shkollore për nivelin ose klasën e përfunduar, nëse i posedojnë;
4. Dokumentacionin tjetër të nevojshëm për verifikimin e kushteve të regjistrimit.

Institucioni arsimor mund të kërkojë dokumente shtesë kur ato janë të nevojshme për përcaktimin e nivelit të regjistrimit dhe verifikimin e përmbushjes së kritereve ligjore.

V. Afati dhe mënyra e aplikimit

Aplikimi bëhet nga data 30.10.20226 deri më 30.11.2026 në institucionin arsimor SHFMU "Mati Logoreci" gjatë orarit të punës.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në administratën e institucionit përkatës arsimor.

VI. Përzgjedhja dhe regjistrimi i kandidatëve

Pas përfundimit të afatit të aplikimit, institucioni arsimor do të bëjë shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve dhe verifikimin e përmbushjes së kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Regjistrimi i kandidatëve bëhet në përputhje me kriteret e konkursit, numrin e vendeve të lira dhe dispozitat ligjore që rregullojnë arsimin dhe aftësimin për të rritur.

VII. Pagesa

Shkollimi kompensues për të rritur në nivelet I dhe II(klasa e parw deri klasa e nwntw) të Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit është falas, në pajtim me nenin 19, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-143.

VIII. Dispozitat përfundimtare

Për informata shtesë, kandidatët mund t'i drejtohen institucionit arsimor përkatës ose Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren.

Konkursi publikohet në mjetet përkatëse të informimit publik, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Drejtoria Komunale e Arsimit
Drejtoresha/ Luljeta Veselaj Gutaj

REPUBLIKA E KOSOVËS★REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETİ
Komuna e Prizrenit★Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Drejtoria e Arsimit dhe e Shkencës
Direktorijat za Obrazovanje i Nauku
Eğitim ve Bilim Müdürlüğü

DRA Nr. 2356/26 29.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT, PRIZREN

Nr.:
Datë:

KONKURS PUBLIK

Për regjistrimin e kandidatëve në programet e arsimit dhe aftësimit për të rritur për nivelin I dhe II të KSNA (klasa e parë deri në klasën e nëntë)

Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 12/2014 për përjashtimet në moshë me rastin e regjistrimit në arsimin dhe aftësimin për të rritur, shpall:

KONKURS PUBLIK PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE NË ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PËR TË RRITUR

I. Qëllimi i konkursit

Qëllimi i këtij konkursi është t'u mundësojë personave që nuk e kanë përfunduar arsimin përkatës brenda moshës së përcaktuar për arsimin e rregullt, të regjistrohen në programet e arsimit dhe aftësimit për të rritur, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

II. Kandidatët që mund të aplikojnë

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët të cilët:

1. Nuk e kanë përfunduar nivelin përkatës të arsimit dhe dëshirojnë ta vazhdojnë ose përfundojnë atë përmes programeve të arsimit për të rritur;
2. Plotësojnë kushtet e përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-143 dhe UA Nr. 12/2014;
3. I nënshtrohen procedurës së verifikimit të dokumentacionit dhe përcaktimit të nivelit përkatës të regjistrimit nga institucioni arsimor kompetent.

Regjistrimi bëhet në përputhje me kriteret ligjore për moshën, nivelin e arsimit të përfunduar dhe dokumentacionin përkatës.

III. Institucionet arsimore dhe programet